



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori ekonomik “Integrated Technology Services” shpk me NIPT L02302032C, me administrator Z. Klodian Zoto, me seli në Adresën: TIRANE Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Papa, Gjon Pali, Pallati F & G, Ap 15, Kutia Postare nr.15.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujën si lëndë të parë”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-24634-05-30-2019

Fondi limit: 99.902.997 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj duke nisur nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e zhvillimit të tenderit është: 03.07.2019 Ora: 11:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 22 DATE 03.06.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**AGI KONS**” shpk. NIPT-i K21622001M
Vlera: 89.315.199 (tetëdhjetë e nëntë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**INTEGRATE TECHNOLOGY**”shpk NIPT-i L02302032C
Vlera: 93.970.962,45 (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e

gjashtëdhjetë e dy presje dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik **“ERMI – PUMP” shpk**

NIPT-i L74326201B

Vlera: 97.903.419,32 (nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik **“METEO” shpk**

NIPT-i L26310801C

Vlera: 99.902.745,32 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dy mijë e shtatëqind e dyzet e pesë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Të skualifikuar:

Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik **“ERMI – PUMP” shpk** me vlerë të ofertës 97.903.419,32 (nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“ERMI – PUMP” shpk** ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin ligjor si dhe ofertën me preventivin e punimeve sipas shojcës 1, por nuk ka paraqitur dokumentacionin teknik dhe financiar të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek kriteret e vecanta të kualifikimit, si më poshtë renditur:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;**
- e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;**

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur **Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9; Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10, Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.**

Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i paplotë për rrjedhojë i parregullt.

AK, ka kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit si më poshtë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **49.951.498 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontrate;
 3. Leje ndertimi/shfrytëzimi për kryerjen e punimeve
 4. Situacionin përfundimtar;
 5. Akt kolaudimi objekti;
 6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **49.951.498 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Për rrjedhojë dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë pikë mungon.

AK ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte të tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6,
Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

poshtë cituar:

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP –1 A (Punime gërmimi në tokë)
- NP –7 A (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)

sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë paisjen e tij me licence si më sipër cituar.

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 10 (dhjetë) vjet.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier Elektrik

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezat e punës dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

7. Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në listat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit të paktën 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

- Grupi I- 3(tre) punonjës

- Grupi II-2(dy) punonjës
- Grupi III- 2(dy) punonjës
- Grupi IV- 2(dy) punonjës
- Grupi V- 1 (një) punonjës
- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda të cilët të jenë dy automakiniste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me deshmi aftësie të lëshuar nga subjektet e akredituar, stafi si më poshtë:

- 4 (katër) hidraulik

11. Shoqëria duhet të paraqesë Certificate **ISO 14001-2015** (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certificate ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007**(e vlefshme)(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certificate ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Gjithashtu Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën 10 mbi disponimin e mjeteve të kërkuara nga AK në dokumentat e tenderit si më poshtë cituar:

16. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pik pese) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë
-
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jepen aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
 - *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
 - *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
 - *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
 - *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
 - *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
 - *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 25.06.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*
- Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.*

17. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Sipas Shtojcës 11.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ERMI – PUMP” shpk **s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur

dokumentacionin e sipercituar, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1. Oferta e paraqitur nga AGI KONS” SH.P.K. me vlerë të ofertës 89.315.199 (tetëdhjetë e nëntë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK, në dokumentat e Tenderit ka kërkuar si më poshtë cituar:

16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pik pese) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton
Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6,
Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).
- (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 25.06.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori Ekonomik “AGI KONS” SH.P.K. ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- Kamion me targa **TR1123N** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **9.4 Ton.** (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton).
- Autovinç me targa **AA 650TH** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **3.5Ton.**
- Kamion me targa **KR 5570 A** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.6 Ton.**

KVO konstaton se mjeti është siguruar me anë të kontratës së qerasë me Nr. 731 rep, nr. 205 kol.

Në përmbushje të kriterit 14 pika a) të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, çertifikatë e pronësisë, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar nga njësia Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhenesit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qirramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

- Kamion me targa **AA 085 NA** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5 Ton. (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton).**
- Kamionçinë me targa **AA874LM** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **2.1 Ton.**
 - Kamionçinë me targa **AA621OP** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.8 Ton. (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton).**
 - Kamioncinë me targa **AA 319 IB** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.9 Ton. (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton).**
- Gjithashtu operatori ekonomik “Agi Kons”sh.p.k në përmbushje të kriterit të kërkuar lidhur me numrin e kamionçinave ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targa AA315NH me kapacitet mbajtës 0,98 ton si dhe bashkëngjitur leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë kontrolli teknik ,kontratë qeraje lidhur ndërmjet palëve “Agi Kons”sh.p.k si dhe shoqërisë Meet Engineering datë 26.07.2016.

Nga shqyrtimi i kontratës së paraqitur komisioni i Vlerësimit të Ofertave evidenton se kontrata e nënshkruar datë 26.07.2016 është me afat 2 vjeçar dhe për pasojë kjo kontratë ka përfunduar efektet e saj.

Akoma më tej KVO nga verifikimi i makinerive të deklaruar në shtojcën 10 nga operatori ekonomik konstatohet se operatori ekonomik “Agi Kons”sh.p.k nuk ka deklaruar kamioncinën me targa AA315NH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon dhe verifikon vetëm mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Theksojmë se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve (sipas listës së mjeteve të kërkuara nga

AK) pasqyron të gjitha mjetet që operatori ka ndërmend të angazhojë për realizimin e objektit të prokurimit dhe këto mjete nuk janë të angazhuara në AK të tjera duke krijuar bindjen kështu AK se operatori ekonomik disponon mjetet për realizimin e kontratë objekt prokurimi.

Gjithashtu sqarojmë se edhe pse operatori ekonomik “Agi Kons” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion shoqërues në sistemin elektronik për mjetin me targa AA319 IB ,AA 681 FT, AA 213HD, AA315 NH. AA261 OE, AA149 VX (mjete të padeklaruara në shtojcën 10) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk do ta marr në shqyrtim për shkak se KVO kontrollon dhe verifikon vetëm mjetet të cilat operatori ekonomik i ka deklaruar në shtojcën 10.

Në kushtet kur operatori ekonomik nuk e ka deklaruar mjetet me targa AA 029 SH,AA 722 HM, AA312NF, AA576 MN,AA 681 FT, AA 213HD në shtojcën 10 dhe në kushtet kur kontrata e qerasë ka përfunduar efektet e saj tregon qartazi se operatori ekonomik “Agi Kons” sh.p.k nuk e disponon dhe nuk zotëon këtë mjet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Sa më sipër cituar **Operatori ekonomik** nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për

- Paraqitjen e **3** kamionave me kapacitet mbajtës min.3.5 ton dhe max 5 ton pasi nga 3 kamiona të kërkuar, shoqëria ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri **dy** kamiona.
- Paraqitjen e **3** kamionçinave me kapacitet mbajtës min.1.5 ton dhe max 2 ton pasi nga 3 kamiona të kërkuar, shoqëria ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri **dy** kamioncina.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionat 3.5 – 5 ton, dhe kamionçinat 1.5 – 2 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të

Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga “METEO” SH.P.K. me vlerë të ofertës 99.902.745,32 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dy mijë e shtatëqind e dyzet e pesë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Meteo” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Meteo” shpk **s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik “Integrated Technology Services” shpk me NIPT L02302032C, me administrator Z. Klodian Zoto, me seli në Adresën: TIRANE, Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Papa, Gjon Pali, Pallati F & G, Ap 15, Kutia Postare nr.15, me vlerë të ofertës: **93.970.962,45** (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy presje dyzet e pesë) lekë pa TVSH., **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2019

Ankesa: Nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

REDI MOLLA

Miratoi: D.Drejt.Prokurimev. L.Ramo
Verifikoi:Prgj. Sek .Prok. I.Gavoçi
Konceptoi: Spec K.Haxhiaj
Kopje:3
Afati i ruajtjes.____ vjet

